

# Zënka gjatë pushimit >



# A e keni ditur...

1. Mbi 3 milionë njerëz në Shtetet e Bashkuara të Amerikës belbëzojnë.
2. 3 deri në 4 herë më shumë belbëzojnë djemtë se vajzat
3. Njerëzit të cilët belbëzojnë janë njësoj të menqur si ata që nuk belbëzojnë.
4. Shumë shkencëtarë kanë provuar të gjejnë se çfarë e shkakton belbëzimin. Asnjëri nuk e di sigurt se çfarë e shkakton atë. Ajo vazhdon në familje. Gjithashtu, kjo është thjeshtë mënyra si funksionon trupi i disa njerëzve. Shkencëtarët ende janë duke kërkuar për të gjetur përgjigjet dhe tanimë kanë bërë shumë përparim në këtë drejtim.
5. Disa fëmijë nuk e ngrisin dorën e tyre në klasë, sepse ata frikësohen që mund të belbëzojnë. Por nuk duhet të kemi turp nga belbëzimi!
6. Nuk ka ndonjë shërim për belbëzimin. Terapia mund të ndihmoj, por duhet të kaloj një kohë për të parë ndryshimin.
7. Terapia mund t'i ndihmoj çdonjërit, pa marrë parasysh se çfarë moshe jeni.

Shumë njerëz të famshëm kanë belbëzuar: James Earl Jones, John Stossel, Kenyon Martin, John Melendez, Bill Walton, Mel Tillis, Nicholas Brendon, Robert Merrill, Carly Simon, Ken Venturi, Bob Love, John Updike, Lewis Carroll, Mbreti George VI, Winston Churchill dhe Marilyn Monroe.

Përpiluar nga Lisa Scott, Ph. D., Universiteti Shtetëror i Floridas

# Zënka gjatë pushimit



Nga Xhemi

Zënka gjatë pushimit

Përktheu nga origjinali:

Burim Azemi

Botuar nga:

Shoqata Kosovare për Belbëzim

Stuttering Foundation of America

P.O. Box 11749

Memphis, Tennessee 38111-0749

Copyright © 2008 nga Stuttering Foundation of America

The Stuttering Foundation of America është një organizatë joprofitabile e dedikuar për parandalimin dhe tretmanin e belbëzimit.

ISBN 978-9951-698-04-7

Katalogimi në botim - (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

82-93-32

159.932

Zënka gjatë pushimit / [Nga Xhemi ; përktheu nga origjinali Burim Azemi].- Prishtinë : Shoqata Kosovare për Belbëzim, 2015. - 29 f. ; ilustr. ;

I.Azemi, Burim

ISBN 978-9951-698-04-7

Qëllimi fillestar për të shkruar këtë tregim ishte që t'i ndihmoja Xhemin për të zhvilluar një vetëdije pozitive lidhur me dallimet mes njerëzve, dhe një vetëdije pozitive lidhur me belbëzimin. Ajo kishte një shoqe të mirë në shkollë që barte pajisje për dëgjim dhe ajo e filloi tregimin lidhur me dy shoqe, njëra me pajisje të dëgjimit dhe tjetra që belbëzonte. Libri është shkruar dhe ilustruar gjatë një periudhe disa mujore dhe Xhemi ishte në gjendje të tregonte lidhur me disa nga ndjenjat e saj lidhur me belbëzimin. Ne e "hulumtuam" belbëzimin duke lexuar libra dhe duke shikuar videon "Belbëzimi: Për fëmijët, nga fëmijët" nga "The Stuttering Foundation of America". Ne mësuam lidhur me ngacmimin, dhe kështu u formua skica e librit "Zënka gjatë pushimit". Temat që janë diskutuar janë: çfarë e bën një shok të mirë, çfarë të bëjmë nëse ju ngacmojnë, dhe çfarë t'u themi njerëzve lidhur me belbëzimin. Xhemi ishte shumë e lumtur që libri i saj mund t'i ndihmonte njerëzit tjerë që belbëzojnë dhe t'i mësonte fëmijët lidhur me belbëzimin.

Julie Gasway, M.A. CCC-SLP

Janar 2008

Dedikuar familjes sime.

Xhemi, 8 vjeqare



Kjo është Molli. Ajo është 5 vjeqare. Ajo ka dëshirë të luaj në shtëpi me kukullën e saj.



Molli ka shumë shokë. Ajo dëshiron të luaj me ta në shtëpitë e tyre ose në shtëpinë e saj.





Molli është e zonja në shkollë, duke u kujdesur për gjërat e saj, duke i ndarë gjërat me të tjerët, është e mirë në sport, i ndjek rregullat dhe është vullnetare. Ajo është një vajzë, motër dhe atlete e shkëlqyer.

Nganjëherë Molli belbëzon. Kur ajo belbëzon, kjo duket si: "Mam-mam-mami"; "d-----ua"; "p-p-p-pak"; "m-----jaltë."

Kur shokët e Mollit e pyesin atë pse ajo belbëzon, Molli thotë: "Nuk e di. Ndoshta është kjo thjeshtë mënyra se si kam lindur."

"Nganjëherë belbëzimi im nuk vërehet shumë. Nuk e di pse nganjëherë ai paraqitet dhe zhduket."




Molli e ka një shoqe që quhet Keti. Keti e bart një pajisje për dëgjim për t'i ndihmuar asaj që të dëgjoj më mirë. Ajo kishte lindur ashtu. Keti është 6 vjeqare.



Keti dhe Mollie janë kërcyeset me litar më të mirat në klasë. Ato mund të kërcëjnë më gjatë dhe më lartë se kushdo tjetër. Keti dhe Mollie madje edhe mund ta kërcëjnë litarin dy herë rradhasi.



Molli dhe Keti shkojnë në kopsht tek zonja Konrad. Zonja Konrad ka flokë të verdhë dhe buzëqeshje të bukur. Ajo ka detyra ditore për të gjithë fëmijët.



Njëra nga detyrat ditore në kopsht është "kalendari". Ishte rradha e Mollit për të treguar para klasës lidhur me ngjarjet e ditës. Ajo e hapi gojën e saj dhe filloi të thotë: "kjo shkon këtu" por ajo u pengua në fjalën "këtu" dhe ajo tingëlloi sikur: "kjo shkon k-----ëtu."



Molli u ndje e tmerruar sepse ajo mendoj se do të ngacmohej për shkak se ajo asnjëherë më parë nuk kishte pasur pengesa në të folur në shkollë. Ajo e përfundoi detyrën e saj dhe vrapoi tek tavolina e saj. Askush nga fëmijët nuk tha asgjë, ende...



Atë ditë gjatë pushimit Molli dh Keti ushtronin kërcimin me litar.

Një djalë i quajtur Xhim e ndaloi litarin derisa ishte duke kërcyer Molli. Ai tha, "Ha! Ha! Ti ke pengesa në të folur."

Keti u zemëruar dhe i tha, "Mos bëj telashe me shoqen time, pasi unë do t'i tregoj mësueses."



Molli ishte aq e dëshpëruar sa u largua me Ketin nga këndi i lojrave. Ato qëndruan mbrapa një peme derisa përfundoi pushimi.

Pas pushimit, Molli dhe Keti i treguan zonjës Konrad lidhur me Xhimin dhe çfarë i kishte thënë ai Mollit. Zonja Konrad i tha Xhimit që më kurrë mos të bënte shaka me asnjërin. Xhimi i kërkoi falje Mollit.

Keti nuk u pajtua me zonjën Konrad, "Jo! Ti duhet ta dërgosh atë te zyrja e drejtorit ose ta përjashtosh atë."

Zonja Konrad i tha Ketit se ajo duhej të ulej dhe mandej i tha, "Keti, nuk është ndonjë gjë e madhe."



Thellë në vete, Mollit mendoi se kjo ishte një gjë e madhe. Ajo e pyeti zonjën Konrad nëse mund të shkonte të takonte këshilltaren e shkollës, zonjën Akrobat. Zonja Konrad i dha leje Mollit dhe Ketit të shkonin te zyrja e zonjës Akrobat.



Molli dhe Keti i treguan zonjës Akrobat lidhur me ngacmimin. Së bashku ato e përgaditën një plan. Molli, Keti dhe zonja Akrobat do të mësonin lidhur me belbëzimin dhe do të bënin një prezantim para klasës së Mollit.

## Molli e kuptoi që:

1) Të gjithë njerëzit janë të ndryshëm, ata i bëjnë disa gjëra mirë dhe disa gjëra tjera jo aq mirë.



2) Ne nuk e dimë saktë se çfarë e shkakton që disa fëmijë të belbëzojnë.

3) Gjërat që mund t'i ndihmojnë fëmijëve që belbëzojnë janë:

a) Dëgjo se çfarë thonë.

b) Mos ngacmo, mbaj ndjenjat e tua për vete, ne të gjithë kemi ndjenja.


c) Është në rregull të bëni pyetje lidhur me belbëzimin, por bëje atë në mënyrë të sjellshme.

d) Trajtoje atë si çdonjërin tjetër.

e) Askush nuk duhet t'i ndërhyj ose t'ia përfundoj fjalët dikujt tjetër.

Molli dhe Ketu dëshironin të bënin prezantimin lidhur me belbëzimin para klasës.

Ato biseduan me zonjën Conrad dhe e caktuan datën. Të gjithë fëmijët u ulën në formë rrethi dhe Molli dhe Ketu e mbajtën prezantimin. Xhimi qëndronte përballë dhe dëgjonte me kujdes.



Molli kishte pak pengesa gjatë prezantimit të saj lidhur me belbëzimin. Logopedja e shkollës i'u tregoi një film në klasë lidhur me belbëzimin.

Molli u ndje në rregull me belbëzimin e saj para klasës. Ajo ishte e lumtur që mund ta bënte prezantimin. Molli u përgjigj në disa pyetje, dhe disa prej tyre ishin pyetje të Xhimit.

Njëra prej pyetjeve ishte - kur keni filluar të belbëzoni?

Molli tha, "Unë fillova të belbëzoj kur isha 3 vjet."

Një pyetje tjetër ishte - Çfarë kanë bërë prindërit e tu që të të ndihmojnë ty?

Molli tha, "Ata janë munduar të më ndihmojnë duke folur vetë ngadalë. Ata gjithashtu kanë dëgjuar se çfarë po them, e jo si po e them. Kjo ishte gjëja më e rëndësishme."



Gjërat që duhet të bëni për të ndihmuar:

1. Dëgjoni.
2. Jeni të sjellshëm.
3. Na trajtoni si çdonjërin tjetër.

Gjërat që nuk duhet t'i bëni:

1. Mos e largo shikimin.
2. Mos më thuaj që të flas më ngadalë.
3. Mos m'i plotëso fjalët.
4. Mos qesh me mua.

Xhimi e pyeti, "Si belbëzon ti?"

Molli i demostroi se si belbëzon, duke i bërë pyetje zonjës Conrad.

Ajo e demostroi se si ajo i zgjat fjalët: "Z-----Zonja

Conrad, a mund të shkoj në toalet?"



Molli i'u tregoi se një zgjatje e vogël e fjalëve ndodh kur ajo e mban një tingull pak më gjatë se tingujt tjerë. Ajo i tregoi Xhimit se si njerëzit mund të thonë një fjalë dy ose tri herë.

"Unë - Unë - Unë mendoj se më nevojiten syzet.

Unë nuk shoh mirë."





E tërë klasa e kuptoi.

Pas prezantimit, fëmijët shkuan në pushim, përveç Mollit.

Zonja Conrad dëshironte ta falenderonte Mollin për prezantimin. Mollin dhe Keti biseduan me zonjën Conrad dhe mandej dolën edhe ato jashtë.

Disa nga shokët e Mollit vrapuan tek ajo dhe i thanë asaj se kishte bërë një punë të mirë duke i sqaruar atyre lidhur me belbëzimin.

Molli u ndje e lumtur dhe mirë. Të gjitha vajzat shkuan në shtëpinë si kështjellë për të luajtur.

Pas shkollës, Molli vrapoi në shtëpi për t'i treguar mamit të saj lidhur me prezantimin. Mami i saj i dhuroi një përqafim të madh dhe i tha, "Unë jam shumë krenare me ty. A të dalim pak për të shëtitur?"

Molli dhe mami i saj e festuan këtë në një qendër tregtare!



Atë natë Molli i tregoi babit të saj se sa e guximshme kishte qenë. Babi i Mollit i tha, "Edhe unë jam krenar me ty! Kur kam qenë i vogël edhe unë kam belbëzuar, gjithashtu."

Mandej Molli dhe babi i saj biseduan lidhur me belbëzimin. Por më vonë mami i tha se tani është koha për të fjetur.

Molli i pastroi dhëmbët, e lau fytyrën, shkoi në toalet, i veshi pizhamat dhe babai e dërgoi në shtrat. Molli tani e dinte se ajo mund të bisedonte gjithmonë me babin e saj për çdo gjë - madje edhe lidhur me belbëzimin.

Babai i saj i tregoi përralla deri sa e zuri gjumi. Molli ishte vërtetë e lumtur për të nesërmen. Ajo ishte e sigurt se mund të bënte gabime ose të kishte pengesa, dhe kjo është plotësisht në rregull.







Xhemi është 8 vjeqare. Ajo dëshiron t'i bëj detyrat e shkollës dhe të shkruaj tregime. Në kohën e lirë ajo noton dhe përgadit ushqimin në kuzhinë. Ajo është duke shkuar në kursin e vallëzimit dhe të patinazhit. Ajo jeton në shtëpi me prindërit e saj, motrën dhe një peshk që quhet Diamant. Kur të rritet ajo dëshiron të bëhet një këshilltare.



Shoqata Kosovare për Belbëzim

[www.belbezimi.org](http://www.belbezimi.org)

 belbezimi

ISBN 978-9951-698-04-7

ISBN 978-9951-698-04-7

